



Npi – 01/27 datë: 28.01.2021

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/114 të datës: 26.04.2019, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më: 28.01.2021 është nxjerrë ky:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -I- TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES

E mbajtur më: 28.01.2021, (e enjte) në ora 10.⁰⁰ h. në sallën e Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: znj.Medina Brahaj, z.Perparim Ramusa, z.Shefki Dauti, z.Herolind Selmani, z.Reshat Mujota, znj.Arbresha Syla, z.Milot Deliu, znj.Fatmire Ferati, z.Naim Zejna, znj.Zarife Rexhaj, znj.Valentina Halili-Ferati, z.Ruzhdi Jashari, z.Besnik Seferi, znj.Marigona Pajaziti, z.Fehmi Hysenaj, znj.Adelina Beqaj, z.Isak Muslija, znj.Diarta Vishesella, z.Muhamet Ademaj, dhe z.Rexhep Gashi.

Përveç anëtarëve të Kuvendit në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Drejtoresha, znj.Shqipe Rexhaj; Zyrtarja Kryesore Financiare znj.Kimete Ukaj; Zyrtari për Informim, z.Lulzim Sahiti; Përfaqësuesi i OJQ-së “YAHR” z.Bekim Krasniqi. Praktikantja, znj.Sevdie Selimi, Zyrtari i IT-së Gazmend Ademaj.

Mbledhjen e hapi Kryesuesja e Kuvendit znj.Medina Brahaj, e cila pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit Konstattoj, Kuorumin prej 18 anëtarëve prezent në mbledhje dhe mund të vazhdojmë me mbledhjen. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 22.12.2020,
2. Pyetje-Pergjigje,
3. Raport i punës së Kuvendit për vitin 2020,
4. Propozim-Vendim për këmbim të pronës së paluajtshme komunale, sipas vendimit të Kuvendit Npi-01/272, të datës 24.11.2020,
5. Propozim-Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm të pronave të paluajtshme në Zonën Kadastrale - Raçak,
6. Propozim-Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm të pronave të paluajtshme në Zonën Kadastrale - Petrovë,
7. Propozim-Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm të pronave të paluajtshme në Zonën Kadastrale - Shtime,

8. Propozim-Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm të pronave të paluajtshme në Zonën Kadastrale - Petroviç (Lagja e Pajtitimit),
9. Rishqyrtimi i Rregullores për Tatimin në Pronë për vitin 2021 sipas rekomandimit të MPL-së,
10. Draft-Rregullore komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2021(pas diskutimit publik),
11. Draft-Plani lokal i Veprimit për Mjedis 2021-2025 (pas diskutimit publik),
12. Draft-Kodi Etik i Komunës së Shtimes (pas diskutimit publik),
13. Informatë e përgjithshme nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale,

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Hap diskutimin për rendin e ditës.

z. Fehmi Hysenaj; Përshëndetje për të gjithë, më vjen mirë që prap po takohemi në këtë sallë të Kuvendit, pas disa mbledhjeve on-line. Materialin e kemi marrë me kohë. Unë kam një propozim konkret, që pikat e propozuara 4, 5, 6, 7, dhe 8 të hiqen nga rendi i ditës, për arsye se dikush mund të dyshojë se po përdorën për qëllim të fushatës zgjedhore, meqenëse tani më veq jemi në fushatë zgjedhore, për zgjedhjet nacionale. Edhe tjetra, këto pika nuk i kemi asgjë me urgjencë, mund të presin dhe të kemi informata më të plota. Nëse këto pika aprovohen si të tilla në rendin i ditës për tu shqyrtuar, unë në shenjë paknaqësie do ta lëshoj mbledhjen, por do të jem prezent në mbledhje për pikat tjera.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Sqaroi, se gjat kësaj kohe ka pas disa zyrtarë të sëmurë nga pandemia Kovid19, dhe për këtë arsye nuk kemi mundur me i bërë përgatitjet e duhura dhe me dalë si Kuvend.

z. Ruzhdi Jashari; Përshëndetje, e mbështesim plotësisht propozimin e Fehmiut, sepse është e vërtetë që veprimet e tilla po përdorën në kohë të fushatës zgjedhore. Ne si Vetëvendosje jemi që pikat 4, 5, 6, 7, dhe 8 të hiqen nga rendi i ditës, dshe pasi të kalon fushata mund të trajtohen.

z. Naim Zejna; Ne edhe në KPF-ë, kemi kërkuar informacione shtesë për këto propozim-vendime, mua për këto pika realisht më mungojnë informacionet e duhura. Njejt si Fehmiu edhe unë propozoj që këto pesë pika të shtyhen për mbledhje tjetër, dhe pikat e radhës të vijnë përpara, sepse konsideroj se nuk bëhet nami pse të presin një muaj.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Drejtyresha, Shqipe Rexhaj, i ka dhënë të gjitha informacionet në KPF-ë, lidhur me këto pika të rendit të ditës.

z. Isak Muslija; Përshëndetje, fillimisht Fehmiut i uroj suksese në zgjedhje, meqenëse është kandidat për deputet nga Nisma Socialdemokrate. Edhe unë pajtohem me propozimet e opozitës që këto pesë pika 4, 5, 6, 7, dhe 8 të shtyhen.

z. Shefki Dauti; Përshëndetje, e shfrytëzoj rastin që ti uroj Benikut ditëlindjen. Unë jam që të vazhdojmë me këto pika, për arsye se ne faktikisht mundemi me i shty pikat veq e veq, duke i pas parasysh informatat shtesë.

z. Muhamet Ademaj; Përshëndetje, suksese kandidatëve për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Edhe unë jam që me u shty pikat 4, 5, 6, 7, dhe 8.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 20 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, me 9 vota "Për" me 10 vota "Kundër" dhe me 1 votë "Abstenim" nuk e aprovoi rendin e ditës të propozuar nga Kryesuesja e Kuvendit në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës, prej 13 pikave.**

*** Kuvendi i Komunës, me 10 vota "Për" me 9 vota "Kundër" dhe me 1 votë "Abstenim" aprovoi rendin e ditës, pa pikat 4, 5, 6, 7, dhe 8, me radhitjen si vijon:**

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 22.12.2020,
2. Pyetje-Pergjigje,

3. Raport i punës së Kuvendit për vitin 2020,
4. Rishqyrtimi i Rregullores për Tatimin në Pronë për vitin 2021 sipas rekomandimit të MPL-së,
5. Draft-Rregullore komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2021(pas diskutimit publik),
6. Draft-Plani lokal i Veprimit për Mjedis 2021-2025 (pas diskutimit publik),
7. Draft-Kodi Etik i Komunës së Shtimes (pas diskutimit publik),
8. Informatë e përgjithshme nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale,

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 22.12.2020

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z. Besnik Seferi; Dje edhe në Komitetin për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, kemi pas vërejtje për Procesverbalin, ne e kuptojmë zyrtarin e Kuvendit, z. Idajet Rexhepin, që është i vetëm dhe nuk po arrinë me i kry të gjitha procesverbalet, prandaj edhe ne po kërkojmë që në Sekretarinë e Kuvendit të shtohet edhe një zyrtarë për me mujt me i plotësuar nevojat dhe me i kry të gjitha punët që kërkohen nga Kuvendi dhe Komitetet.

z. Naim Zejna; Pajtohem plotësisht edhe unë me Besnikun, sepse ne edhe më parë kemi kërkuar që të shtohet edhe një zyrtarë në Sekretarinë e Kuvendit, sepse procesverbalet po vijnë me vonesa dhe pastaj po harrohen gjërat që janë thënë. Po ashtu ne kemi kërkuar që të na ofrohen edhe stenogramet në formë të disqeve. Kam një vërejtje te faqja e 7 te pika 7 e rendit të ditës ku është shkruar: “muajin dhjetor i cili është muaj elektoral” nuk kam thënë për muajin elektoral por për vitin elektoral.

z. Ruzhdi Jashari; I përkrahu propozimet e kolegëve, sepse zyrtari i Kuvendit është i ngarkuar shumë me punë. Pastaj i kam edhe disa vërejtje për pikën e rendit të ditës pyetje-përgjigje.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 20 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, unanimisht aprovoi, Ekstrakt Procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 22.12.2020, me vërejtjet e propozuara.**

Pika 2

Pyetje-Përgjigje

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z. Naim Zejna; Unë kam disa pyetje, 1. Çka është punuar deri tash me Hartat Zonale, kur do të vien ato në Kuvend? 2. A janë verifikuar kufijtë e parcelës komunale që ja kemi dhënë në shfrytëzim firmës STN-Davidovc, nëse qëndron brenda kufijëve, apo mos e ka zgjeruar hapsirën, dhe tjetra a ka filluar me paguar për tokën komunale që e ka marrë në shfrytëzim? 3. A janë caktuar kufijtë për pronën e Sali Beqa, në Davidovc? 4. Drutë e konfiskuara që gjenden në oborrin e shkollës së mesme profesionale, a janë shitë apo jo, sepse po qarkullojnë disa informata, se janë shitë?

z. Besnik Seferi: Kam këto pyetje, 1. Pikërisht te drutë edhe unë kam pyetje se a janë shitur, nëse jo atëherë propozoj që ato tu ndahen skamnoreve? 2. Kurë do të përfundojnë punimet te Ura që është duke u ndërtuar në fshatin Rashincë? Sepse pikërisht për këtë arsye edhe është duke ndodhur vërshime. 3. Pse nuk është bërë ndriçimi në fshatin Rashincë? 4. A është planifikuar edhe në rrugën “Beqa” të ndërtohet Trotuari dhe Ndriçimi? 5. Çka po bëhet me ndërtesën e Stacionit të Policisë në Shtime, a do të mbetet si Muze apo jo?

z. Ruzhdi Jashari: Kam këto pyetje: 1. Sa i përket projektit të ndërtimit të Kolektorit për trajtimin e ujërave të zeza, (që është në kuadër të kredisë me qeverinë austriake) kur ka filluar dhe deri ku ka arritur realizimi i këtijë projekti, sepse nuk ka fare transparencë, dhe nuk kam marrë përgjigje në këtë pyetje prandaj kërkojmë informata të detajuara, dhe po e përsëris prap këtë pyetje? 2. Pse nuk

po vendosen shenjat për informim në rrugët kryesore, që tregojnë vendodhjen e Muzeut të Shtimes, edhe përkundër që kam kërkuar edhe më parë?

z.Fehmi Hysenaj: Fillimisht, edhe unë kam vërejtje sepse nuk i kamë përgjigjet e plota. Kam këto pyetje: 1. Pse nuk po bëhet ndriçimi publik në rrugën kryesore të dy fshatrave Godanc i epërm dhe Godanc i poshtëm, në pjesën të mali, ku është i shtruar Trotuari? 2. Pse mungon ndriçimi te fusha e sportit në fshatin Godanc i epërm? 3. Pse nuk është vendosur një pllakë (si shenjë) për të përkujtuar vrasjen e dy fëmijëve të Liman Hysenaj që ka ndodhur nga granatimet e forcave Serbe, gjatë Luftës? 4. Pse nuk ka të ndërtuar kanalizim fekal te rrugët e kuqe, që i themi ne, në fshatin Petrovë? 5. Pse në fshatin Zborc nuk ka as kanalizim e as ndriçim? 6. Pse nuk po pastrohen trotualet në Shtime, që janë të parapara me Kontratë, me theks të veçant te rruga e shkollës së mesme - Gjinnazi?

z.Rexhep Gashi: Edhe unë kam vërejtje se pse nuk po i marrim përgjigjet në pyetjet tona. Unë kam këto pyetje: 1. Te projektet kapitale për vitin 2020, cilat projekte nuk janë realizuar, dhe pse kanë dështuar? 2. Pse nuk ka ndërhyrje për ta rregulluar trotuarin në rrugën "Ibrahim Rugova" në fshatin Gjyrkovc, lagja te Hani?

z.Perparim Ramusa: Përshëndetje, te pyetja që e bëri Fehmi Hysenaj, unë po përgjigjem për sa i përket kanalizimit e ndriçimit në fshatin Zborc. Unë konsideroj se ngritja e këtyre pyetjeve nga Fehmiu ka të bëjë krejtësisht për fushatë elektorale, sepse Fehmiu ka qenë këtu në këtë Kuvend që tri vite dhe asnjëherë nuk e ka propozuar, asnjë projekt për fshatin Zborc, për me u futë në listën e projekteve kapitale në Buxhet. Dhe mendoj se kjo do të ishte përgjigja më e mirë.

z.Fehmi Hysenaj: Këto nuk janë pyetje të miat por të subjektit tim Nisma Socialdemokrate, zoteri Perparim, pyetja është e qartë, Pse në fshatin Zborc nuk ka kanalizim e as ndriçim?

z.Perparim Ramusa: Pikërisht, edhe unë po ju pyes juve, pse që tre vite nuk keni propozuar asnjë projekt për fshatin Zborc?

z.Muhamet Ademaj: Kam këto pyetje: 1. Te rruga "Eqrem Qabej" në Shtime, banorët po ankohen në Komitetin për Komunitete, përmes Arton Demirit anëtar i këtij Komiteti, se nuk kanë fare ujë për pije, a ka mundësi për me i furnizuar me ujë edhe këta banorë të kësaj lagje? 2. Kush e ka për detyrë që ta pastroj pjesën e rrugës deri te shkolla e mesme profesionale?

z.Shefki Dauti: Përshëndetje, unë kam këto pyetje: 1. Një ujëmbledhës (Reshetkë) te rruga "Emin Musliu" është prishë, pse nuk po rregullohet? 2. Rruga "Tranzit" duke filluar nga Davidovci është prishë, pse nuk po rregullohet? 3. Flamuri i madh që është i vendosur nalt në kodër, është shkyer pse nuk po i rrini gati me e ndrruar?

z.Isak Muslija: Pajtohem me propozimin e Fehmiut për sa i përket ndriçimit edhe trotuareve, sepse siç e dini ka mjaft shumë edhe Çenë endacak që janë rrezik për kalimtarët, në anën tjetër ka të ndërtuara trotuare, sikurse është rasti në drejtim të fshatit Llanisht, që faktikisht nuk kanë bërë asgjë, veç se e kanë ngushtuar dhe e kanë paralizuar edhe më shumë atë rrugë. Ndërsa rruga e Zborc-it konsideroj se është shumë me rëndësi prandaj e përkrahu propozimin e Fehmiut. Perparimi po reagon por që konsideroj se edhe ne mund të kontribuojmë.

z.Perparim Ramusa: Faktikisht edhe unë nuk jamë i kënaqur qind për qind me investimet që janë bërë në fshatin Zborc, por po shpresojmë se do të rregullohet më mirë.

znj.Adelina Beqaj: Përshëndetje, unë kam këto pyetje: 1. Në rrugën e Petrovës janë të vendosura barriera të cilat janë shumë të larta, a do të rregullohen këto barriera dhe kurë? 2. Kurë do të fillojë punën Çerdhja e re për fëmijë?

Pika 3

Raport i punës së Kuvendit për vitin 2020

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Unë do ta prezantoj këtë raport që e kam përgatitur në formë të shkruar, të cilin edhe e keni marrë me kohë, dhe e keni lexuar. Në vazhdim Kryesuesja, e lexoi raportin në pikat kryesore. (Shih dokumentin) Në vazhdim hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Reshat Mujota; Faleminderit për raportin. Unë e kam një pyetje, se si është shpenzuar buxheti i ndarë për Kuvendin, sepse nuk kemi asnjë informacion për këtë.

z.Naim Zejna; Kuvendi i jep raport Kuvendi. Unë këtë e shoh më shumë si përmbledhje e punës një vjeqare të Kuvendit, ose si Informatë që i dedikohet publikut.

z.Ruzhdi Jashari; Unë mendoj se ky është një njoftim se qka kemi bërë gjatë periudhës një vjeqare, se sa që është një raport. Unë e përkrahu propozimin e zotëri Reshat Mujota, sepse duhet ta dimë saktë se sa dhe si është shpenzuar buxheti i ndarë për Kuvendin. Çështje tjetër shqetësuese është ndarja e 100.000€ për pandeminë Kovid19, e që nuk kemi informacion se sa dhe si jan shpenzuar, ndërkaq që kur ishte koha për ti aprovuar Kuvendi këto mjete, Kryetari u zotua se për sasinë dhe mënyrën e shpenzimit të këtyre mjeteve do të keni raport specifik. E që deri so kjo nuk ka ndodhur. Propozoj që mbledhjet e Komiteteve të tjera me u mbajtë para mbledhjes së Kuvendit dhe KPF-së.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Ju falënderoj për pyetjen që ka të bëj me buxhetin e Kuvendit, do të ju informoj edhe për këtë pyetje me Email.

z.Fehmi Hysenaj; Mirë është që janë përmbledhur informatat në një vend. I përkrahu vërejtjet që u dhanë për sa i përket Raportit, edhe unë mendoj se duhet të jetë informatë. Unë kam një vërejtje të dëgjimet publike sepse ato po mbahen vetëm formalisht. Pastaj pse nuk po qiten në Ueb-faqen e Komunës, nuk është se krejt vendimet janë në Ueb-faqe.

z.Muhamet Ademaj; Kuvendi e ka bërë punën e mirë, edhe Sekretaria e Kuvendit po ashtu, prandaj duhet përkrahur dhe votuar raportin.

z.Besnik Seferi; Pajtohem me parafolsit, po lidhem edhe unë me aspektin e ndarjes së 100.000€ për pandemi Kovid19 e që nuk e kemi një raport të saktë për mënyrën e shpenzimit të këtyre mjeteve, edhe pse ne ende jemi në pandemi, dhe kjo duhet të jetë shqetësim për secilin prej neshë. Nuk kemi informatë as për kontributin që kanë dhënë donatorët për këtë çështje. Prandaj edhe unë e kërkoj një raport të tillë.

znj.Arbresha Sylja; Përshëndetj, realisht unë nuk desha me marrë fjalën, sepse nuk desha me e lavduar veten, por po e marr sepse më nxitën diskutimet tjera. Faktikisht ne jemi munduar që me e kursyer buxhetin. Unë nuk e di se a mos ka një amnezi, sepse qe disa herë kemi marrë përgjigje për sa i përket këtyre 100.000€ ose po dëshironi të bëni politikë.

z.Besnik Seferi; Unë ose nuk kam qenë në atë mbledhje, ose nuk është dhënë raportim nga Kryetari për këto 100.000€. Unë këtu nuk po bëj politikë, por unë vërtetë nuk e di se kush prej familjeve ka marrë ndihma. Unë nuk e kamë marrë një raport të tillë, kush e ka marrë e lus që të ma sjellë edhe mua që ta shoh.

z.Perparim Ramusa; Ne këtu po flasim për raportin e punës së Kuvendit, ndërsa raportin për pandeminë Besniku le ta kërkon te ekzekutivi. Çka ka lidhje puna e Kuvendit me raportin e ekzekutivit.

z.Shefki Dauti; Unë po kërkoj nga drejtoritë, që hyjnë në kuadër të Komiteteve siç është psh. Shëndetësi, Arsimi etj. që të marrin pjesë në mbledhjet e Komitetit, sepse po na pamundësohet mbajtja e mbledhjeve për shkak të mungesës së tyre. Ata po mungojnë mbi 60-70% të rasteve, prandaj ti si Kryesuese duhet të bisedosh me drejtorat dhe të kërkosh nga ta që të marrin pjesë në mbledhjet e Komiteteve.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 19 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, unanimisht aprovoi Raportin e Punës së Kuvendit të Komunës së Shtimes për vitin 2020, me vërejtjet e anëtarëve të Kuvendit.**

Pika 4

Rishqyrtimi i Rregullores për Tatimin në Pronë për vitin 2021 sipas rekomandimit të MPL-së
Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Dha 5 minuta pauzë në ora 11.20h. Mbledhja e Kuvendit vazhdoi në ora 11.35h. Në vazhdim Kryesuesja sçaroi se në këtë pikë ne duhet ti marrim dy vendime, njëri

vendim ka të bëj me anulimin e Rregullores Komunale për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2021, me numër të protokolit Npi-01/267 të datës: 24.11.2020, të cilin në vazhdim do ta arsyetojë zyrtarja kryesore financiare znj.Kimete Ukaj, dhe vendimin tjetër që ka të bëj me aprovimin e Normave Tatimore për Komunën e Shtimes gjatë vitit 2021. Në vazhdim fjalën për prezantimin e kësaj pike ja dha Kimete Ukaj.

znj.Kimete Ukaj, zyrtare kryesore financiare; Përshëndetje, ne kemi udhëzim nga Ministria që Rregulloren e Tatimit në Pronë për vitin 2021, me e anuluar, konform nenit 9 të Ligjit për Tatimin në Pronë Nr.06/L-005. Dhe për vitin 2021 nevojitet të aprovohet vendimi për Normat Tatimore, të cilin ne e kemi propozuar dhe që e kemi marrë me kohë. Normat tatimore që i kemi propozuar ne me këtë propozim-vendim janë normat më të ulta të mundshme, kështu që nuk kemi mundësi të diskutojmë për uljen e tyre eventuale, por vetëm nëse eventualisht dëshironi me i ngritë këto norma. Unë ju ftoj që fillimisht të votoni që ta anuloni rregulloren për taksa për vitin 2021 e pastaj ta aproveni vendimin për Normat Tatimore.

z.Shefki Dauti; Pas rekomandimit që ka dhënë Ministria e Pushtetit Lokal, për anulimin e rregullores për Taksa për vitin 2021 si dhe pas prezantimit që e bëri zyrtarja kryesore financiare znj.Kimete Ukaj, ne si grup i subjektit politik PDK-ë jemi që fillimisht të anulohet Rregullorja e pastaj të aprovojet vendimi për miratimin e Normave Tatimore për vitin 2021.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 17 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, unanimisht vendosi të anulojë Rregulloren Komunale për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2021, me numër protokoli Npi-01/267 të datës: 24.11.2020.**

*** Kuvendi i Komunës, unanimisht aprovoi Normat Tatimore për vitin 2021 në Komunën e Shtimes si vijon:**

Nr.	Përshkrimi i Pronës	Norma Tatimore
1	Pronat Rezidenciale	0.15%
2	Pronat e banuara	0.15%
3	Pronat komerciale	0.18%
4	Pronat industriale	0.15%
5	Pronat bujqësore	0.15%
6	Pronat e braktisura dhe objektet e pa banuara	0.15%
7	Pronat e papërfunduara	0.15%
8	Për njësitë bujqësore të parcelave	0.15%
9	Për njësitë pyjore te parcelave	0.15 %
10	Për njësitë rezidenciale te parcelave	0.15%
11	Për njësitë komerciale te parcelave	0.15%
12	Për njësitë industriale te parcelave	0.15%

Pika 5

Draft-Rregullore komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2021(pas diskutimit publik)

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Fjalën për prezantimin e kësaj pike ja dha Kimete Ukaj.

znj.Kimete Ukaj, zyrtare kryesore financiare; Bazuar në Vendimin e Kuvendit, Npi – 01/306 Datë: 22.12.2020, për ta nxjerrë në Diskutim Publik, Propozim-Rregulloren Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2021, për afatin prej 15 ditësh, ne kemi organizuar debatin On-line për shkak të pandemisë Kovid19, mirëpo mund të them se nuk ka ndonjë propozim konkret i cili duhet të inkorporohet në propozim-vendim. Prandaj unë ju ftoj që ta aproveni kështu siç është propozuar.

z.Nim Zejna; Unë edhe më herët kam kërkuar por edhe tani po e përsëris kërkesën që Rregulloret që kanë implikime financiare të vijnë në Kuvend për miratim para miratimit të buxhetit komunal. Për sa i përket diskutimit publik, po e di që kemi pas dhe kemi ende pandemi, por në KPF- kam

“abstenuar” mu për shkak se së paku është dashur të organizohet një takim pune me grupet parlamentare për ta diskutuar këtë draft rregullore, prandaj unë edhe kësaj radhe do të “abstenoj”.

z.Shefki Dauti; Unë mendoj se me vetë titullin që thuhet pas diskutimit publik, nënkuptohet që secili ka pas mundësinë për me kontribuar me propozimet e tijë me e-mail, por kjo nuk është bërë, kështu që diskutimi publik është kryer, e tani unë ju ftoj që ta votojmë.

z.Nim Zejna; Diskutim publik ka pas e di, edhe e di që kemi pas mundësi me kontribuar me e-mail, por unë mendoj se shumë më mirë do të ishte që me u takuar fizikisht si grupe parlamentare, dhe me diskutuar bashkërisht.

z.Fehmi Hysenaj; Do të ishte mirë që të mbahet evidencë për prezencën në debat publik. Unë kamë marrë pjesë i vetmi dhe kamë bërë disa propozime. Ne siç e dini nuk jemi këtu anëtarë të shoqërisë civile por jemi anëtarë të Kuvendit të Komunës ku edhe bëhet politikë, por jo politikë ditore.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 18 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, me 17 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim” aprovoi Rregulloren komunale për taksa, tarifa dhe gjoba për vitin 2021.**

Pika 6

Draft-Plani lokal i Veprimit për Mjedis 2021-2025 (pas diskutimit publik)

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Hamëz Tërshani.

z.Hamëz Tërshani, drejtor i DSHP; Pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit prezantoi këtë pikë. Bazuar në Vendimin e Kuvendit, Npi – 01/308 të datës: 22.12.2020, për ta nxjerrë në Diskutim Publik, Draft-Planin Lokal të Veprimit për Mjedis 2021-2025 për komunën e Shtimes, për afatin prej 15 ditësh, ne kemi organizuar debatin publik On-line për shkak të pandemisë Kovid19, mirëpo nuk ka pas ndonjë propozim konkret i cili mund të inkorporohet në dokument. Prandaj unë ju ftoj që ta aprovon, dhe nëse ka ndonjë pyetje, jam këtu për tu përgjigjur.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Lexoi Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, dhe hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Ruzhdi Jashari; Më vjen keq që nuk kamë marrë pjesë direkt në mbledhjen e KPF-së për ta dhënë kontributin tim. Unë po kërkoj që materiali me na ardhur me kohë. Në mbledhjen e Dhjetorit 2020 ne i kemi dhënë propozimet tona për sa i përket kësaj pike. Në mënyrë taksative e kam përmendë Turizmin malor, si dhe Muzeun e Shtimes të cilat është dashur të inkorporohet në Planin lokal të veprimit. Unë realisht nuk e di a janë inkorporuar apo jo, kërkoj nga drejtori që të na jep shpjegime.

znj.Fatmire Ferati; Përshëndetje, unë e falënderoj drejtorin për këtë informacion për planin lokal të veprimit. Sa i përket pjesës të Trashëgimisë Kulturore, duhet të trajtohet me një dokument tjetër, që duhet ta përgatitë në të ardhmen e afërt Komuna e Shtimes. Mendoj se ky plan i veprimit është i kompletuar mjaft mirë dhe ju ftoj që ta aprovojmë.

z.Fehmi Hysenaj; Unë kam një vërejtje, se pse në ekipin e hartimit të dokumentit ka munguar përfshirja e opozitës, pastaj pse në dokument nuk është paraqitur ekipi që ka punuar në këtë plan. Propozimi im është që ky plan duhet të plotësohet edhe me aspektin e Gurëthyesve, sepse kemi bukur shumë në komunën tonë. Pastaj në dokument përveq aktiviteteve, duhet të paraqitet edhe kostoja e tyre. Ka disa lumej që janë në dokument, e faktikisht nata nuk ekzistojnë në teren, kështu që dokumenti duhet të përmirësohet.

z.Ruzhdi Jashari; Nuk mundet që ky plan i veprimit të kalohet shkel e shko, nën faktin duhet të presim deri sa të bëhet një plan i Trasahëgimisë Kulturore.

z.Naim Zejna; Pajtohem me Fehmiun se nuk është përfshi edhe opozita. Unë në këtë rast nuk kam shumë për të thënë.

z.Hamëz Tërshani, drejtor i DSHP; Ky plan mundet me shërbyer si udhërrëfyes, për dokumentet tjera. Sa i përket koston buxhetore është hipotetike sepse është shumë vështirë me paraparë në

aspektin financiar se sa kanë me kushtuar. Por sa i përket vërejtjes se pse nuk është përfshi edhe opozita, unë do ta marr në shenim, kështu që vërejtjet janë për me u përmirësuar.

znj. Adelina Beqaj; Te banimi social, ishte përfshirë edhe kostoja financiare, atëherë u tha pse është përfshi edhe kostoja financiare, a mund ta gjejmë ne një balanc se a me përfshi apo jo koston financiare.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 16 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, me 14 vota “Për” me 1 votë “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim” aprovoi Planin Lokal të Veprimit në Mjedis 2021-2025, në komunën e Shtimes.**

Pika 7

Draft-Kodi Etik i Komunës së Shtimes (pas diskutimit publik)

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Besnik Shala.

z. Benik Shala, zyrtar i personelit; Pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit prezantoi këtë pikë. Ne e kemi përgatitur për Kuvend këtë Draft-Kodin e etikës për komunën e Shtimes, i cili është i bazuar në draftin e Departamentit për Shërbyesit Civilë, dhe kemi vërejtë që është një draft mjaft i mirë. Bazuar në Vendimin e Kuvendit, Npi – 01/307 të datës: 22.12.2020, për ta nxjerrë në Diskutim Publik, Draft-Kodi Etik i Komunës së Shtimes, për afatin prej 15 ditësh, ne e kemi organizuar debatin publik, por pjesëmarrja nuk ka qenë e dëshirueshme, dhe nuk ka pas ndonjë propozim konkret i cili mund të inkorporohet në dokument. Janë njoftuar me draftin edhe të gjithë zyrtarët. Bazën ligjore e ka, kështu që unë ju ftoj që ta aprovoni, dhe nëse ka ndonjë pyetje, jam këtu për tu përgjigjur.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Lexoi Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, dhe hapi diskutimin për këtë pikë.

z. Naim Zejna; Ne i japim mbështetje Besnik Shalës, sepse është një dokument bukur i mirë dhe i kompletuar, prandaj unë them që ta votojmë.

znj. Fatmire Ferati; Edhe unë kamë qenë në Komision, dhe konsideroj se është bërë një punë e mirë. Kështu që unë ju ftoj në emër të grupit të Partisë Demokratike që ta aprovojmë.

z. Fehmi Hysenaj; Materialin e kamë marrë me kohë. Nuk e di a ka mundësi të inkorporohet një element, që u ndalohet drejtorëve të shkollave dhe zyrtarëve tjerë publik për me bërë fushatë gjatë orarit të punës.

z. Benik Shala, zyrtar i personelit; Sa i përket pjesëmarrjes të drejtorëve ose zyrtarëve tjerë publik nëpër fushatë është e ndaluar me Ligj, dhe nuk ka nevojë me u përfshi në kodin etik.

z. Ruzhdi Jashari; Sa i përket çështjes të fushatave politike, ka mjaftueshëm dispozita ligjore që e rregullojnë, mirëpo pyetja është ec e nali. I ke drejtorat këtu në Komunë që dalin e bëjnë fushatë në orarin e punës. Kodi Etik duhet me kaluar, sepse Komunës deri tani i ka munguar një kod i tillë etik. Edhe me direktivat Evropiane është e obligueshme me pas kodin e etikës. Kodin e aprovojmë nuk është ndonjë problem por halli i madh është zbatimi i tij në praktikë.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 16 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, unanimitisht aprovoi Kodin Etik të Komunës së Shtimes.**

Pika 8

Informatë e përgjithshme nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Musa Baftiu.

z. Musa Baftiu, drejtor i DSHMS; Përshëndetje për të gjithë, unë e kam shkruar informatën, të cilën e keni marrë të gjithë me kohë. Informatën unë do ta lexoj në pikat kryesore, por do të ndalem pak më shumë te çështja e pandemisë Covid19 e cila ende është prezent në mesin tonë. (Shih dokumentin)

z.Besnik Seferi; E falënderojmë drejtorin për informatën e dhënë në mënyrën e duhur. E dimë që gjatë kësaj periudhe të pandemisë më të sfiduarit kanë qenë mjekët dhe stafi mjekësor në përgjithësi. Sa i përket punës që është bërë duhet me i vlerësuar, edhe për punën e mirë që e kanë bërë jashtë kompetencave të tyre. Unë e kam lexuar informatën, por edhe drejtori e ka elaboruar mirë atë. Kam disa pyetje për drejtorin, kur po flet për OJQ-të a po flet këtu për “Karitasin”? Pyetja e dytë ka të bëjë me orarin e barnatoreve, ka pas më herët një marrveshje që një barnatore të punojë 24 orë, kjo tani po duket se është ndërprerë, e që është mjaft sfiduese për banorët e komunës tonë, a ekziston një marrveshje e tillë, nëse jo a mund ta bëni përsëri? Edhe pyetja e tretë është për sa i përket Radiologjisë, a do të ketë në QKMF-Shtime Radiolog apo jo?

z.Fehmi Hysenaj; Faleminderit për informatën, i falënderoj të gjithë që kanë punuar dhe po punojnë me përkushtim gjatë kohës së pandemisë. Informata është një shënim shumë i vlefshëm. Sa i përket menagjimit të Pandemisë ne si Komunë jemi në vendin e dytë. Shihet se numri i testeve 1250 është i pakët në krahasim me rastet e infektiveve me virus që kanë qenë 537. Shprehi keqardhje për humbjen e jetës për 21 persona në komunën tonë. Pyetje për drejtorin, sa paguajmë ne për marrëveshjen me “Karitasin” dhe a e përfillin konkursin? Dhe një pyetje tjetër sa janë subvencionuar me nga 50 euro?

z.Ruzhdi Jashari; Ngushllime për të gjithë banorët që kanë humbur më të dashurit e tyre. Ka familje që kanë qenë të izoluar, kanë qëndruar policia aty dhe nuk kanë marrë asnjë lloj ndihme. Çerdhja e fëmijëve nuk e di ku po bie a te ju a te DKA-ja ku ligji vlenë vetëm për disa e për disa tjerë jo.

z.Muhamet Ademaj; Faleminderit për informatën. Ne po ballafaqohemi me sfida të ndryshme. Unë desha ta pyes drejtorin se sa ekonomi familjare marrin ndihma sociale? Sepse ata që nuk punojnë duhet me ju ndihmuar.

znj.Arbresha Syla; Unë po ndjej obligim nga aspekti profesional të reagoj, sepse aty kam punuar edhe vetë. E falënderojmë drejtorin për informatën. U shprehu ngushllime të gjitha familjeve që kanë humbur të afërmit e tyre. Në QKMF-ë ne kemi ofruar shërbime 24 orë. Kemi dhënë shërbime edhe për familjet skamnore. E falënderoj drejtoreshën Mirdita për angazhimin dhe ndihmën e sajë për stafin mjekësor. Sindikata ka vendosur për ndihma por kjo nuk ka lidhje me neve këtu në Kuvend. Këtu ka kontribuar edhe qytetari njëri për tjetrin. I falënderoj të gjithë që kontribuan por që jemi në rrugë të mirë që ta tejkalojmë Pandeminë.

z.Fehmi Hysenaj; Edhe unë dua ti falënderoj për kontributin që kanë dhënë, po ashtu edhe Qendrën për Punë Sociale.

znj.Adelina Beqaj; Ne si QPS-ë nuk kemi lënë derë pa trokitur për ti shpërnda ndihmat për të prekurit me Covid19.

z.Naim Zejna; Faleminderit, sepse kemi marrë informata që nuk i kemi ditur. Edhe unë i bashkëngjitem ngushllimeve për të gjithë ata që i kanë humbur anëtarët e familjeve. Mjekët dhe stafin e falënderojmë për angazhimin e tyre. Më vjen mirë që nuk është rritë numri i rasteve sociale gjatë periudhës së deritashme të pandemisë. Pyetje për drejtorin për sa u përket pakove të ndihmave, e para pako ishte prej 65 eurove ndërsa e dyta prej 75 eurove, pse ky ndryshim?

z.Rexhep Gashi; I falënderoj të gjithë ata që kanë kontribuar si dhe stafin mjekësor. Unë kam një pyetje për drejtorin, automjetet e QKMF-së a janë në rregull teknikisht, dhe pse ato nuk i kontrolloni sipas afatit që e përcakton Ligji?


Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Ne e kemi kërkuar një informatë të këtillë, dhe tani e kemi futur në planin e punës për muajin Janar. Unë mendoj se është mirë që e kemi një informatë të tillë nga DSHMS-ë.

z.Musa Baffiu, drejtor i DSHMS; Faleminderit për pyetjet, po filloj me dy gjera që u ngritën, çështja e “Karitasit” dhe Apotekave. Te pjesa e “Karitasit” i kemi 18.700€ të ndara për mbulimin e pjesës tonë të marrveshjes. Sa i përket orarit të punës së Apotekave, ne e kemi një marrveshje me ta që të punojnë deri në ora 2 pas mesnate, që është duke u zbatuar edhe sot. Objektivi im është që me

pas një barnatore në QKMF-ë e cila kishte me punuar 24 orë. Në vitin 203 deri në vitin 2015 ka pas një marrveshje të përbashkët me “Karitasin”për sa i përket rritjes së stafit mjeksor në QKMF-ë, mirëpo Auditori i përgjithshëm ka thënë se nuk ka marrveshje nëse paguani mbi 50%. Dhe tash qka kemi bërë është se kemi vendosur që ti blejmë shërbimet ku i kemi 63.000€ për këtë destinim. Sa i përket Radiologut edhe ne jemi të interesuar që ta kemi një Radiolog por ja që nuk po ka, kështu që jemi në pritje të një Radiologu. Ndryshimi në mes të 65% dhe 75% te pakot e ndihmave janë sepse është punë e kontrollimit dhe shërbimeve. Ndërsa sa i përket aspektit të kontrollit teknik të automjeteve të QKMF-së unë nuk i di, por ate qka mund të ndaj me ju tani është se po planifikojmë që ta sigurojmë edhe një automjet për QKMF-në.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Ju falënderoj për diskutimet, dhe për pjesëmarrjen e juaj në mbledhjen e Kuvendit, meqenëse diskutime tjera nuk ka mbledhjen e përfundoj në ora 12.⁵⁶h.

Procesmbajtësi:
Idajet Rexhepi



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj

